



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
KRYETARI

V E N D I M

PËR

AUDITIMIN E USHTRUAR NË DREJTORINË RAJONALE TË MJEDISIT LEZHË DHE INSPEKTORATIN SHTETËROR TË MJEDISIT, PYJEVE, UJËRAVE DHE TURIZMIT LEZHË ME OBJEKT “PËRPUTHSHMËRINË E AKTIVITETIT EKONOMIK-FINANCIAR DHE MJEDISOR”, për periudhën nga data 01.01.2018 deri më datën 31.12.2019.

Nga auditimi i përputhshmërisë dhe rregullshmërisë, ushtruar në Drejtorinë Rajonale të Mjedisit Lezhë dhe Inspektoratin Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve, Ujërave dhe Turizmit Lezhë, u shqyrtua veprimtaria e subjekteve në drejtim të çështjeve që lidhen me vlerësimin e aktivitetit ekonomik e financiar, planifikimin, kryerjen e inspektimeve, miratimin e lejeve mjedisore të tipit C, ruajtjen e mjedisit dhe të pyjeve, përmbushjen e funksioneve rregullatore për zbatimin e kushteve dhe kritereve të caktuara në lejet mjedisore, monitorimin dhe vlerësimin e gjendjes së mjedisit, përmbushjen e misionit të garantimit dhe respektimit të kërkesave ligjore në fushën e mbrojtjes së mjedisit, etj.

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe Projektvendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të Aseteve dhe Mjedisit, shpjegimet e dhëna nga subjektet e audituara, si dhe vlerësimet mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit të mësipërm, Drejtori i Drejtorisë së Standardeve dhe Sigurimit të Cilësisë, si dhe Drejtori i Përgjithshëm, në mbështetje të neneve 10, 15, 25 dhe 30 të Ligjit nr.154/2014 miratuar në datën 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”,

VENDOSA

I. Të miratoj Raportin Përfundimtar të auditimit “Për vlerësimin e aktivitetit ekonomiko-financiar, planifikimin, kryerjen e inspektimeve, ruajtjen e mjedisit dhe të pyjeve, monitorimin dhe vlerësimin e gjendjes së mjedisit, respektimit të kërkesave ligjore në fushën e mbrojtjes së mjedisit”, të ushtruar në Drejtorinë Rajonale të Mjedisit Lezhë(aktualisht Agjencia Rajonale e Mjedisit Lezhë) dhe Inspektoratin Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve, Ujërave dhe Turizmit Lezhë, sipas programit të auditimit nr.558/1, datë 18.06.2020, për veprimtarinë nga data 01.01.2018-31.12.2019.

II. Të miratoj Opinionin e auditimit, rekomandimet¹ për përmirësimin e gjendjes dhe të kërkoj marrjen e masave sa vijon:

A. OPINIONI I AUDITIMIT

Opinion i kundërt²

Ne audituam përputhshmërinë e veprimtarisë së DRISHMPUT Lezhë dhe DRM Lezhë për periudhën 01.01.2018-31.12.2019, nëse kjo veprimtari është kryer duke respektuar dhe zbatuar, ligjet, rregulloret në fuqi, marrëveshjet, duke përfshirë këtu shpenzimet/investimet vjetore të buxhetit, miratimin e lejeve mjedisore, kryerjen e inspektimeve, zbatimin e kuadrit ligjor për vendosjen e penaliteteve, sekuestrimin e mallrave dhe administrimin e tyre, që lidhen dhe ndikojnë në përdorimin e fondeve/burimeve të DRISHMPUT-së dhe DRM-së, ku rezultuan devijime nga kuadri ligjor rregullator në fuqi (kriteret), si pasojë e mospërbushjes së detyrave funksionale të institucioneve të auditimit.

*Nga auditimi mbi përputhshmërinë, i mbështetur në Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI 4000, Rregulloren e Procedurave të Auditimit dhe në Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë së KLSH-së, i kryer në subjektin DR ISHMPUT Qarku Lezhë dhe DRM Lezhë rezultuan devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi (kriteret) të cilat nën gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale dhe të përhapura, efektet e të cilave mbështesin dhënien e një **opinionit të kundërt**.³*

Nga auditimi mbi përputhshmërinë, sa i takon shkallës së zbatimit të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat është rënë dakord (kriteret e auditimit të përputhshmërisë), bazuar në procedurat e kryera dhe evidencën e përftuar u evidentua se aktiviteti i kryer nga DRISHMPUT dhe DRM Lezhë për zbatimin dhe dhënien e akt-miratimeve për lejet mjedisore, kryerjen e inspektimeve në fushën e mjedisit, pyjeve, hartimin dhe zbatimin e buxhetit, përgjatë periudhës 01.01.2018-31.12.2019, nuk ka qenë plotësisht në përputhje me kuadrin ligjor për hartimin dhe zbatimin e buxhetit, me dispozitat ligjore për dhëniet e lejeve mjedisore, kryerjen e inspektimeve, duke mos përmbushur detyrat funksionale të institucionit, të cilat në gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale dhe të përhapura.

Baza për opinionin e përputhshmërisë.

Ne e kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik (ISSAI). Përgjegjësitë tona lidhur me këto standarde janë përshkruar më hollësisht në seksionin “Përgjegjësitë e Audituesit për auditimin e përputhshmërisë”, pjesë e raportit tonë përfundimtar. Ne jemi të pavarur kundrejt subjektit të audituar, e theksuar kjo në ISSAI-n 10- Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t, si dhe ISSAI 30- Kodi Etik, apo edhe çështje të tjera, të cilat janë përmendur në ISSAI-n 4000 “Standardi i Auditimit të Përputhshmërisë”. Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura, përfshirë këtu edhe Kodin e Etikës së KLSH-së, miratuar me Vendimin nr.27, datë 20.04.2018, të Kryetarit të KLSH-së. Auditimi ynë përfshin kryerjen e procedurave, me qëllim marrjen e evidencave të auditimit mbi ligjshmërinë dhe rregullshmërinë e transaksioneve.

¹ Rekomandimet për Inspektoratin Mjedisor do t'i përcillen për zbatim Agjencisë Rajonale Mjedisore Lezhë, si institucion i cili ka marrë atributet e inspektimit mjedisor me shkrirjen e Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve, Ujërave dhe Turizimit, sipas përcaktimeve të VKM Nr.568, datë 17.7.2019 “Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit.

² Sipas Manualit të Auditimit Përputhshmërisë të KLSH-së, miratuar me Vendimin nr.66, datë 2306.2020, grupi II pika 7.3.3, Opinion të kundërt nëse aspektet e mospërputhjes janë materiale dhe të përhapura.

³ Neni 4, pika 2, shkronja b, paragrafi i tretë “Opinion i kundërt, jepet në ato raste kur është marrë siguri e arsyeshme, është siguruar një evidencë e mjaftueshme dhe e plotë, por devijimet e pajtueshmërisë janë materiale dhe të përhapura”, në Rregulloren e Procedurave të Auditimit, miratuar me Vendimin nr.63, datë 22.06.2020, të Kryetarit të KLSH-së.

Përgjegjësitë e Drejtuesve të DR ISHMPUT Qarku Lezhë dhe DRM Lezhë:

Drejtimi i DR ISHMPUT Qarku Lezhë dhe DRM Lezhë, është përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikat, ligjet dhe rregulloret e aplikuara. Stafit drejtues është përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me të gjithë bazën ligjore dhe rregullatore në fuqi.

Përgjegjësitë e audituesve të KLSH:

Objektivi ynë lidhet me garantimin e sigurisë së arsyeshme mbi përputhshmërinë e aktivitetit të ish-DRISHMPUT Qarku Lezhë dhe DRM Lezhë, me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, si dhe mbi përdorimin e duhur dhe eficient të burimeve financiare të institucionit. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesi i KLSH, gjithashtu aplikon edhe gjykimin dhe skepticizmin profesional në punën audituese. Ne komunikuar me drejtuesit ndër të tjera, edhe për planifikimin në kohë dhe përmbajtjen e auditimit si dhe konkluzionet/gjetjet, duke përfshirë edhe të metat e kontrollit të brendshëm, që ne kemi identifikuar gjatë auditimit tonë. Ne identifikuar çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin dhe i përshkruam ato në raportin e auditimit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

Ne besojmë se dëshmitë e marra gjatë punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazat për përgatitjen e opinionit të kundërt.

B. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Në 104 rastet e audituara, Akti i Miratimit të Lejes “C” përmban kushte të përgjithshme sipas formatit tip. Është konstatuar se në kushtet e lejes nuk janë të integruar normat e lejimit të shkarkimit në ajër dhe në ujërat sipërfaqësor e nëntokësor, me qëllim që të jenë specifike për të individualizuar veprimtarinë në raport me impaktet dhe risqet në mjedis në kundërshtim me Kreun IV, pika 10 germa (a) të VKM nr.419, datë 25.6.2014 “Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi të tipave, A, B, dhe C”. Për pasojë, kufijtë përkatës të normave të lejueshëm të shkarkimeve nuk janë përfshirë në kontratën e miratimit të lejes mjedisore të tipit C, veçanërisht për subjekte me risk të lartë me vendndodhje buzë lumenjve, bregdetit apo zonave të mbrojtura. Aktet e verifikimit në terren dhe dhënia e mendimeve nga DRM Lezhë për miratimin e lejeve mjedisore të tipit C, japin përshkrim të shkurtra, jo të qarta dhe shteruese (*Më hollësisht trajtuar në faqet 27-64 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

1.1.Rekomandim: DRM Lezhë, të marrë masa për të përditësuar kushtet e kontratës së lejes mjedisore C, në të gjitha rastet, për subjektet që me ndryshimet e reja transferohen në lejen mjedisore të tipit B, duke përfshirë normat e lejimeve të shkarkimeve në ajër, ujërat sipërfaqësor dhe nëntokësor me indikatorë të matshëm, me qëllim individualizimin e veprimtarive sipas tipologjive përkatëse të veprimtarisë në raport me impaktet dhe risqet mjedisore.

Brenda muajit Mars 2021

2. Gjetje nga auditimi: DRM Lezhë, në përgjithësi ka zbatuar afatin ligjor, brenda 3 (tre) ditëve nga data e marrjes së aplikimit për leje mjedisore të tipit C nga AKM-ja, u ka dërguar një kopje të aplikimit njësisë të vetëqeverisjes vendore, sipas përcaktimeve të VKM nr.419, datë 25.06.2014, Kreu IV, pika 3 e cila përcakton se “ARM-ja, brenda 3 (tri) ditëve pune nga data e marrjes së

aplikimit nga AKM-ja, dërgon një kopje të aplikimit në njësinë e qeverisjes vendore (NJQV) përkatëse, e cila jep mendimin e saj me shkrim brenda 3 (tri) ditëve pune”.

Por, nga shqyrtimi i praktikave për vitin 2018 rezulton se DRM Lezhë ka dërguar 90 shkresa, nga të cilat vetëm 22 shkresa ua ka adresuar bashkive ndërsa 68 shkresa ua ka adresuar njësive administrative të këtyre bashkive.

Për vitin 2019, u ka dërguar 54 shkresa bashkive ndërsa 8 shkresa ua ka adresuar njësive administrative, *në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 5 “Njësitë e vetëqeverisjes vendore janë bashkitë dhe qarqet, të cilat realizojnë vetëqeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”*, DRM Lezhë duhet t’u kishte adresuar bashkive përkatëse të gjitha njoftimet e aplikimeve për leje mjedisore të tipit C, pasi njësitë administrative nuk kanë strukturën përkatëse, kapacitetet dhe burimet për vlerësimin mjedisor, strukturë kjo që gjendet në bashki, konkretisht Inspektorati i Mjedisit (*Më hollësisht trajtuar në faqen 61 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

2.1.Rekomandim: Agjencia Rajonale Mjedisore Lezhë, të marrë masa që, për çdo korrespondencë për leje mjedisore dhe dhënie mendimi për raportet e vlerësimit të ndikimit në mjedis, të njoftojë strukturat përkatëse në bashki dhe jo njësitë administrative bashkiake.

Brenda muajit Mars 2021

3. Gjetje nga auditimi: Për vitin 2018 rezulton se nuk kanë likuiduar tarifën vjetore të lejes mjedisore të tipit C, 159 nga 404 subjekte në shumën 318,000 lekë ndërsa në vitin 2019 nuk kanë likuiduar tarifën 382 nga 531 subjekte në shumën 764,000 lekë, duke sjellë të ardhura të munguara për periudhën 2018-2019 në vlerën totale 1,082 mijë lekë. DRM nuk ka marrë masa ndaj subjekteve që nuk kanë likuiduar tarifën vjetore, për të revokuar lejet mjedisore në kundërshtim me pikën 6 të nenit 25 të ligjit nr.10448 datë 17.07.2011 “Për lejet e mjedisit” (*Më hollësisht trajtuar në faqet 14-16 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

3.1.Rekomandim: Agjencia Rajonale Mjedisore Lezhë, të marrë masa që të identifikojë saktësisht numrin e debitorëve, veçanërisht të subjekteve që transferohen në kategorinë e lejeve mjedisore të tipit B. Në këtë kuadër, të njoftojë Agjencinë Kombëtare të Mjedisit, me qëllim që këtyre subjekteve debitorë t’u refuzohet aplikimi për lejen e re mjedisore B, deri në shlyerjen e detyrimeve përkatëse.

Menjëherë

4. Gjetje nga auditimi: Në qarkun e Lezhës, nga 531 subjekte të pajisur me leje mjedisore të tipit C, vetëm 16 subjekte kanë sjellë raportet e vetëmonitorimit mjedisor. Konkretisht, për periudhën 2018-2019 është konstatuar se 316 subjekte nuk kanë dorëzuar asnjëherë raportet e vetëmonitorimit, 120 subjekte vetëm 1 herë, 57 subjekte vetëm 3 herë. DRM-ja duhet të kishte kërkuar revokimin e lejes mjedisore në përputhje me nenin 27 “Revokimi i lejes së mjedisit të tipit A, B dhe C”, të ligjit nr.10448, datë 14.07.2011 “Për lejet e Mjedisit” (*Më hollësisht trajtuar në faqen 24-64 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

4.1.Rekomandim: Agjencia Rajonale Mjedisore Lezhë të njoftojë Agjencinë Kombëtare të Mjedisit për ato subjekte që transferohen në kategorinë e lejeve mjedisore B, të cilave t’u refuzohet aplikimi për lejet mjedisore B, deri në dorëzimin e raporteve të vetëmonitorimit në DRM Lezhë.

Brenda muajit Mars 2021

5. Gjetje nga auditimi: Në 2 raste, në zonën e mbrojtur Kune-Vain-Tale dhe Laguna e Patokut janë miratuar leje mjedisore të tipit C në kundërshtim me kuadrin rregullator, përkatësisht për praktikën:

-Dosja mjedisore në emër të subjektit fizik “X”, në zonën e mbrojtur Kune-Vain-Tale, për veprimtarinë “*Impiant/instalimi gatimi dhe tregtimi i produkteve ushqimore të gatshme dhe*

gjysmë të gatshme”, ku është konstatuar miratimi i lejes mjedisore të tipit C në mungesë të kontratës me operatorë të licencuar me objekt grumbullimin, tërheqjen dhe asgjësimin e ujërave të zeza të krijuara nga veprimtaria prodhuese e personit fizik në kundërshtim me ligjin nr.9115, datë 24.7.2003 “Për trajtimin mjedisor të ujërave të ndotura”. Në rastin konkret, ujërat e zeza shkarkohen në një gropë septike të betonuar në rërë.

-Dosja mjedisore në emër të subjektit “Y” në zonën e mbrojtur Laguna e Patokut për veprimtarinë “*gatimi dhe tregtimi i produkteve ushqimore të gatshme*”, ku rezulton se shkarkimi i ujërave të ndotura bëhet në një gropë septike të betonuar, të vendosur në brendësi të ujërave të Lagunës së Patokut. Për këtë subjekt Drejtoria Rajonale e Mjedisit Lezhë nuk ka administruar vërtetimin dhe dokumentacionin përkatës që provon se subjekti disponon kontratë qiraje me Agjencinë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura për ushtrimin e aktivitetit në zonën e mbrojtur Laguna e Patokut, sipas udhëzimit nr.129, datë 23.0.2016 “Për miratimin e procedurës së dhënies në përdorim me kontratë qiraje të sipërfaqeve në zonat e mbrojtura”, duke sjellë rrezik për shkarkime në ujërat sipërfaqësor dhe nëntokësor, në kundërshtim me kushtet e lejes të tipit C.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me ligjin nr.81/2017 “Për zonat e mbrojtura”, neni 19. ligjin nr.111/2012 “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, neni 67 germa (e) “Veprimtari të ndaluara në brigje dhe plazhe” me Kreun IV, pika b të VKM nr.419, datë 25.6.2014⁴ (*Më hollësisht trajtuar në faqet 28-30 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

5.1.Rekomandim: Agjencia Rajonale Mjedisore Lezhë të marrë masa për t’u kërkuar subjekteve “X” dhe “Y plotësimin e dokumentacionit me kontratën e shërbimit për pastrimin e gropës septike dhe në bashkëpunim me subjektet përkatëse të merren masa të menjëhershme për zhvendosjen e gropës septike jashtë brezit ranor dhe ujërave të Lagunës së Patokut, në të kundërt, për mosplotësimin e kushteve të revokojë lejen mjedisore.

Brenda muajit Mars 2021

6. Gjetje: DRM Lezhë, në të gjitha rastet për miratimin e lejeve mjedisore të tipit C për subjektet që ushtrojnë veprimtarinë “prerje dhe përpunim druri” nuk ka administruar në funksion të shpalljes së moratoriumit në pyje, kontratat e këtyre subjekteve me operatorë të licencuar të huaj që veprojnë në aktivitetin e shitjes së lëndës drusore. Për subjektet që operojnë me veprimtarinë e përpunimit të drurit, një kontratë e tillë do të garantonte që subjekti që përfiton lejen mjedisore të mos e siguronte nga persona të paautorizuar dhe informalë që presin lëndë drusore në mënyrë të paligjshme, në kundërshtim me ligjin nr.5/2016 “Për shpalljen e moratoriumit në pyje në Republikën e Shqipërisë”, neni 4. Për pasojë, këto subjekte kanë përfituar lejen mjedisore pa dorëzuar dokumentacionin përkatës që vërteton sigurimin e ligjshëm të lëndës drusore nga operatorë të huaj, për shkak se në Republikën e Shqipërisë janë pezulluar të drejtat ekzistuese për shfrytëzimin e fondit pyjor publik/privat, të fituara sipas procedurave ligjore në fuqi (*Më hollësisht trajtuar në faqet 27-64 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

6.1. Rekomandim: Agjencia Rajonale Mjedisore Lezhë të marrë masa që për të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtarinë “prerje dhe përpunim druri”, të kërkojë dorëzimin e kontratave me operatorë që janë të licencuar në veprimtarinë e shfrytëzimit të lëndës drusore. Në të kundërt, të revokojë lejen mjedisore dhe të njoftojë Agjencinë Kombëtare të Mjedisit për refuzimin e aplikimit, për subjektet që transferohen në kategorinë e lejeve mjedisore të tipit B.

Menjëherë

⁴Me qëllim shmangien e përsëritjeve, duke qenë se baza ligjore e DRM-së është kryesisht VKM nr.419, datë 25.6.2014 “Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi të tipave A, B dhe C, për transferimin e lejeve nga një subjekt te tjetri, të kushteve për lejet respektive të mjedisit, si dhe rregullave të hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKL-ja”, përgjatë këtij materiali, ky akt rregullues do të përmendet si VKM nr.419 datë 25.06.2014, pa u shoqëruar me emërtesën përkatëse.

7. Gjetje nga auditimi: Në 2 raste, DRM Lezhë ka miratuar leje mjedisore C për subjekte që u përkasin kategorive të lejeve mjedisore B.

-Nga shqyrtimi i dosjes nr.37, datë 04.07.2019 të personit juridik “X” për lejen mjedisore C për veprimtarinë “prodhimi i produkteve të përbëra tërësisht nga druri”, rezulton se subjekti, sipas kapacitetit është në kategorinë e lejeve mjedisore B, pasi rezultati i veprimtarisë është 3200 m³ në vit ose 2200 m³, mbi kufirin e lejes mjedisore të tipit C(1000 m³). Madje, subjekti ka paguar tarifën për leje mjedisore të tipit B dhe nga DRM Lezhë i është miratuar leja e tipit C. Është konstatuar se subjekti nuk ka paraqitur vlerësimin paraprak për ndikimin në mjedis në kundërshtim me ligjin nr.10440, datë 07.07.2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis” shtojca 2, pasi ndodhet në kushtet kur ka aplikuar për leje mjedisore për instalim të ri. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me ligjin nr.10448, datë 14.7.2011 “Për lejet e mjedisit”, shtojca 1 “Lejet e mjedisit të tipave A, B dhe C në varësi të kapacitetit prodhues kufi”, duke iu nënshtruar tarifave të ulëta vjetore për lejen mjedisore, prej 2,000 lekë nga 5,000 lekë që i nënshtrohen subjekteve me leje mjedisore të tipit B.

-Nga shqyrtimi i dosjes nr. 76, datë 20.11.2018 të personit juridik “X” për leje mjedisore të tipit C, për veprimtarinë “prodhimi i produkteve të përbëra tërësisht apo kryesisht nga druri”, në përshkrimin e instalimit, subjekti ka përcaktuar kapacitetin prej 950 m³, rreth 50 m³ më pak nga niveli i kapacitetit të lejes së tipit B. Kjo e dhënë e bën të diskutueshëm kategorizimin e këtij aktiviteti në grupin e lejeve C. Nga ana tjetër, vet përcaktimi ligjor përmes tog-fjalëshit, se “ka gjasa të jetë 1000 m³” ja atribuon të drejtën e vlerësimit vet DRM-së për të gjykuar se subjekti mund ta kapërcejë limitin prej 950 m³ gjatë një viti. Për rrjedhojë, duke qenë se subjekti është në limitet e kapaciteteve, DRM Lezhë duhet të kishte gjykuar në vlerësimin e saj se subjekti duhet të aplikonte për lejen mjedisore të tipit B. Kjo theksohet edhe nga fakti se subjekti nuk operon në sipërfaqe 50 m² sikurse pretendon, por sipas ortofotove nga portali ASIG, subjekti shfrytëzon një sipërfaqe toke prej 28000 m² në kundërshtim me VKM nr.419, datë 25.06.2014, pika 1.6 (*Më hollësisht trajtuar në faqen 37 dhe 48 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

7.1.Rekomandim: Agjencia Rajonale Mjedisore Lezhë të marrë masa për të bërë një rivlerësim të dosjes nr.37 të personit juridik “X” dhe dosjes nr.76, datë 20.11.2018 të personit juridik “Y” duke shqyrtuar kapacitetet sipas kufijve të kategorisë së lejes mjedisore të tipit B si dhe të kërkojë dorëzimin e certifikatës së pronësisë ose kontratës së qirasë për rastin “Y” në të kundërt të njoftohet AKM për refuzimin e aplikimit për leje mjedisore B, pasi subjekti shtrihet përtej vendndodhjes ku ka deklaruar se operon.

Brenda muajit Mars 2021

8. Gjetje nga auditimi: DRM Lezhë, për periudhën 2018-2019 ka dhënë 12 mendime për raportet e vlerësimit të ndikimit në mjedis për aktivitetet me objekt *ndërtim “HEC”*, nga të cilat për dy hidrocentrale ka dhënë mendim negativ. Në dosjet e VNM-ve të thelluara, ekzistojnë procesverbalet e takimeve dhe konsultimeve me qytetarët. Në dy raste, ku janë konstatuar ndikime në monumente të natyrës dhe arkeologjike, nga ana e DRM Lezhë nuk janë dhënë argumentime të qarta dhe shteruese në aspektet mjedisore dhe ligjore. Në të gjitha rastet, DRM Lezhë në dhënien e mendimit thekson se ndikimet në mjedis janë minimale dhe të rikuperueshme, por nuk argumenton se mbi çfarë analize apo baze është arritur në këtë konkluzion.

-DRM Lezhë, për periudhën 2018-2019 ka dhënë mendime për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis (VNM) dhe për leje të tipit B për veprimtari me objekt *“Gurorë dhe miniera”*. Në dokumentacionin e dosjeve për dhënien e mendimeve për VNM e leje mjedisore u konstatua se në 3 raste nuk ishin relacionet apo procesverbalet e konsultimeve me publikun, pavarësisht se në aktin e mendimit shpreheshin se “u krye procesi i dëgjësës me publikun”. Një kopje e

procesverbaleve nuk u janë dërguar njësive përkatëse të vetëqeverisjes vendore që kanë nën juridiksion territorin e vendndodhjes së aktiviteteve të subjekteve aplikuese për leje në kundërshtim me Kreun II pika 2/c të VKM-s nr.419 datë 25.06.2014. Për 19 mendimet e dhëna, DRM nuk ka marrë asnjë informacion nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit nëse këto praktika janë përfunduar me miratim apo refuzuar (*Më hollësisht trajtuar në faqet 64-76 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

8.1.Rekomandim: Në të gjitha rastet, për dhënie mendimi për lejet mjedisore të tipit B dhe A, si dhe për VNM-të paraprake dhe të thelluara, DRM të marrë masa që t'i hartojë mendimet e dhëna në bashkëpunim me banorët e prekur, përmes një argumentimi të qartë ligjor dhe mjedisor, duke vlerësuar veçanërisht rastet kur nga ndërtimi i HEC-it preken monumente natyrore dhe arkeologjike si dhe të vlerësojë impaktet mjedisore dhe sociale tek komunitetet përkatëse.

8.2.Rekomandim: Agjencia Rajonale Mjedisore Lezhë për të gjitha rastet, për dhënie mendimi për lejet mjedisore të tipit B dhe A, si dhe për VNM-të paraprake dhe të thelluara, të marrë masa dhe t'i kërkojë Agjencisë Kombëtare të Mjedisit informacion mbi përfundimin apo jo të procedurave të lejeve mjedisore si dhe të refuzojë dhënien e mendimeve kur nga ana e AKM-së nuk i përcillet i plotë dokumentacioni shoqërues, sikurse është konstatuar.

Në vijimësi

9. Gjetje nga auditimi: Në 3 raste, DRM Lezhë ka miratuar lejen mjedisore të tipit C për veprimtarinë “stacione transferimi për mbetje jo të rrezikshme”, pa administruar kontratën e shërbimit të subjekteve me operatorë të licencuar në fushën e “landfillit” dhe transferimin e mbetjeve, në kundërshtim VKM nr.419, datë 25.6.2014, kushti 6 i kontratës tip “Menaxhimi i mbetjeve” dhe VKM nr.229, datë 23.04.2014 “Për miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe të dokumentit të transferimit të mbetjeve jo të rrezikshme” (*Më hollësisht trajtuar në faqet 70-79 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

9.1.Rekomandim: Agjencia Rajonale Mjedisore Lezhë të marrë masa për t'u kërkuar subjekteve që ushtrojnë veprimtarinë “Stacione transferimi për mbetje jo të rrezikshme” dorëzimin e kontratës së shërbimit me operatorë të licencuar në aktivitetet e “landfillit” dhe largimit të mbetjeve, në të kundërt, për mos plotësim të njoftohet AKM për refuzimin e aplikimit për lejen e re mjedisore të tipit B.

Brenda muajit Mars 2021

10. Gjetje nga auditimi: Në dy raste, përkatësisht për subjekte që operojnë buzë lumit Mat dhe në zonën “Rana e Hedhun”, konstatohet që nuk janë verifikuar kushtet për trajtimin e ujërave të ndotur.

-Nga shqyrtimi i dosjes nr.5 të personit fizik “X”, subjekti ka përshkruar në kërkesën për leje mjedisore të tipit C për shkarkimin e të ujërave të ndotura se “*të gjitha ujërat e përdorura gjatë aktivitetit grumbullohen në gropë septike dhe më pas ato shkarkohen në një përrua të fshatit, ngjitur me lokalit*”. Efektet mjedisore janë goxha të ndjeshme në këtë rast pasi derdhja e ujerave të ndotura bëhet në basenin e lumit Mat. Sa më sipër, DRM Lezhë nuk duhet të kishte miratuar lejen mjedisore të tipit C për arsye se te përshkrimi i instalimit vet subjekti ka theksuar dhe pranuar shkarkimin e ujërave të ndotura në përroin pranë objektit.

-Nga shqyrtimi i dosjes nr.30 me subjekt Y”, sipas përshkrimit në Kërkesën për Leje Mjedisore Tipit C në zonën “Rana e Hedhun”, për trajtimin e ujërave të ndotura përdoret gropë septike rreth 92.32 metra larg ndërtesës. Subjekti “Y” nuk ka paraqitur të dhënat teknike ndaj impiantit të trajtimit të ujërave të zeza si dhe mungon përshkrimi i instalimit apo kontrata me subjekte të licencuar për largimin e mbetjeve.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me ligjin nr.11/2012 “Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore” dhe VKM nr 419, datë 25.6.2014 (*Më hollësisht trajtuar në faqen 39 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

10.1.Rekomandim: DRM Lezhë të marrë masa për t'u kërkuar subjekteve "X" dhe "Y" plotësimin e kushteve mjedisore për shkarkimet e ujërave të ndotura, konkretisht dorëzimin e kontratës për pastrimin dhe asgjësimin e mbetjeve të gjeneruara nga aktiviteti, në të kundërt të merren të gjitha hapat ligjorë për sanksionimin e subjekteve.

Menjëherë

11. Gjetje nga auditimi: Në 14 raste, nga ana e Drejtorisë Rajonale Mjedisore Lezhë është miratuar leja mjedisore e tipit C në mungesë të certifikatës së pronësisë për objektin përkatësisht në 9 raste dhe në mungesë të përcaktimit të aktivitetit sipas ekstraktit të QKB përkatësisht në 5 raste, e për pasojë subjektet respektive kanë përfutur leje mjedisore të tipit C për aktivitete që nuk i kanë patur në fushën e veprimtarisë së tyre. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me VKM nr.419, datë 25.6.2014 kontrata Tip, shtojca 3"*(Më hollësisht trajtuar në faqet 27-64 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*.

11.1.Rekomandim: Agjencia Rajonale Mjedisore Lezhë të marrë masa për t'u kërkuar subjekteve përkatëse dorëzimin e certifikatës së pronësisë, kontratës së qirasë, vërtetimit të procesit të legalizimit dhe përditësimin e ekstrakteve në QKB, sipas rastit, për ato veprimtari që transferohen në lejen mjedisore të tipit B.

Brenda muajit Mars 2021

12. Gjetje nga auditimi: Në 8 raste, nga ana e Drejtorisë Rajonale Mjedisore Lezhë janë miratuar leje mjedisore të tipit C për veprimtari "magazininim i hekurishteve/skrapeve të metalit që nuk përmbajnë materiale të rrezikshme", si dhe për aktivitete "Riparim pajisjesh motorike" në kundërshtim me kushtet e lejes C, konkretisht në mungesë të kontratës së shërbimit me operatorë të licencuar për largimin dhe asgjësimin e mbetjeve metalike dhe të ngurta.

- Në 9 raste, nga ana e Drejtorisë Rajonale Mjedisore Lezhë janë miratuar leje mjedisore të tipit C për subjekte që kanë aplikuar për veprimtarinë "Furnizim me karburant dhe gaz" në mungesë të relacionit teknik MNZ, mjetet e nevojshme për mbrojtjen nga zjarri të miratuara nga Drejtoria e MNZ Lezhë.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me VKM nr.419, datë 25.6.2014, me VKM nr.660, datë 31.10.2018. "Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve të metaleve" si dhe me urdhrin e ministrit nr.315,dt. 24.08.2017 "Për procedurat e lëshimit të vërtetimit teknik për subjektet që kryejnë aktivitet në fushën e përpunimit, transportimit dhe tregimit të naftës dhe nënprodukteve të saj *(Më hollësisht trajtuar në faqet 27-64 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*.

12.1.Rekomandim: Agjencia Rajonale Mjedisore Lezhë të marrë masa për t'u kërkuar subjekteve dorëzimin e kontratës së shërbimit me operatorë të licencuar për mbledhjen dhe trajtimin e mbetjeve, plotësimin e kushteve specifike që lidhen me veprimtarinë e magazinimit të hekurishteve, në të kundërt të informojë AKM që këtyre subjekteve t'u refuzohet aplikimi i ri për leje mjedisore të tipit B, në rast mos përmbushje të kushteve.

12.2.Rekomandim: Agjencia Rajonale Mjedisore Lezhë të marrë masa që t'u kërkojë subjekteve që ushtrojnë veprimtarinë "furnizim me karburant/gaz", dorëzimin e relacionit teknik të MNZ si dhe të njoftojë Agjencinë Kombëtare të Mjedisit për refuzimin e aplikimeve për subjektet që transferohen tek leja mjedisore B, në rast se nuk përmbushin kushtet.

Menjëherë

13. Gjetje nga auditimi: Në 5 raste, nga ana e Drejtorisë Rajonale Mjedisore Lezhë janë miratuar leje mjedisore të tipit C për subjekte që kryejnë veprimtaritë "prodhim i plastikës", "prodhim përpunim bojërash", "prodhim produktesh ushqimore", dhe "thertore dhe rritje intensive e derrave", ku për dy veprimtaritë e para përdoren dhe gjenerohen kimikate dhe lëndë

organikë me risk të lartë mjedisore, që derdhen në gropë septike pranë tokave bujqësore, në mungesë të kontratës me operatorë të licencuar për largimin e mbetjeve, përfshirë largimin e mbetjeve shtazore. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim VKM nr.419, datë 25.06.2014, kushti 6 i kontratës tip “Menaxhimi i mbetjeve”(Më hollësisht trajtuar në faqet 27-64 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

13.1.Rekomandim: Agjencia Rajonale Mjedisore Lezhë të marrë masa që t’u kërkojë subjekteve që do të transferohen në lejen mjedisore të tipit B, që ushtrojnë veprimtaritë “prodhim i plastikës”, “prodhim përpunim bojërash”, “prodhim produktesh ushqimore” dhe “thertore dhe rritje intensive e derrave”, dorëzimin e kontratave me operatorë të licencuar për trajtimin e mbetjeve.

Brenda muajit Mars 2021

14. Gjetje nga auditimi: Dosjet përkatëse të lejeve mjedisore janë pa inventarë një pjesë e tyre mbahen në formatet CD si dhe mungon zyra e arkivës në kundërshtim me nenin 23 të ligjit nr.9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat” (Më hollësisht trajtuar në faqet 27-64 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

-Nga auditimi u konstatua se nuk është kryer dorëzimi i detyrës nga punonjësit e ISHMPUT në kundërshtim me ligjin nr.9154, datë 6.11.2003 “Për arkivat”, Neni 43 “Dorëzimi i dokumenteve të institucioneve shtetërore në arkivat përkatës”, përkthuar sipas nenit 9 shkronjat “b”, “c” , “ç” dhe “d” të këtij ligji, bëhet sipas afateve normative të përkthuar në këtë ligj. Dosjet e DRMISHMPU-t janë të shpërndarë në mënyrë të çrregullt në disa dosje, problem ky që i ka krijuar vështirësi grupit të auditimit gjatë kryerjes së auditimit të praktikave të inspektimit (Më hollësisht trajtuar më gjerësisht në faqet 80-129 të projekt-raportit)

14.1.Rekomandim: Agjencia Rajonale Mjedisore Lezhë të marrë masa për sistemin dhe inventarizimin e të gjithë dokumentacionit të lejeve mjedisore të tipit C, përfshirë inventarizimin e dosjeve të inspektimeve të kryera në vitet paraardhëse nga Inspektorati Shtetëror i Mjedisit, Pyjeve, Ujërave dhe Turizmit, Lezhë.

Menjëherë

15. Gjetje nga auditimi: Nga analiza e fondeve të programuara në buxhetet dhe të alokuara për shpenzime të përdorura nga njësia shpenzuese DRM Lezhë rezulton se, fondet për shpenzime janë në kushtet e pamjaftueshmërisë për realizimin e funksioneve të institucionit, sepse ka mungesa investimi për pajisje zyre e mjete transporti për lëvizjen e specialistëve për kontroll dhe monitorim të subjekteve që janë pajisur me lejet mjedisore të çdo tipi. Ka mungesa në ambient pune, ku edhe ato në dispozicion janë në kushtet të papërshtatshme dhe të pamjaftueshme për punonjësit.

-DRM Lezhë, për periudhën 2018-2019, nga mosparashikimi e mos përfshirja në zërin “Shpenzime të tjera transporti, udhëtim e dieta” për punonjësit nuk ka llogaritur dhe planifikuar shpenzime udhëtimi për distancat mbi 50 km dhe për shërbimet që zgjatin mbi 3 ditë, në kundërshtim me VKM nr.329, datë 20.04.2016 kreu III, ka sjelle mos përmbushje të detyrave funksionale. (Më hollësisht trajtuar në faqet 19-26 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

15.1.Rekomandim: Agjencia Rajonale Mjedisore Lezhë, me qëllim krijimin e kushteve të punës për punonjësit e institucionit, duke përfshirë edhe ambientin për arkiv/protokoll, të kërkojë nga AKB rritjen e fondeve të programuara për shpenzime operative në mbështetje të funksioneve dhe të përmbushjes së detyrave DRM -së.

Brenda muajit Mars 2021

16. Gjetje nga auditimi: Nga shqyrtimi i 22 dosjeve për leje mjedisore të tipit C, të refuzuar për periudhën 2018-2019 rezulton se në aktin e refuzimit të lejes mjedisore, nga DRM Lezhë përcaktohet kryesisht tek të gjitha praktikatat se “Kërkesa për leje mjedisore të tipit C ka mospërputhje, por nuk argumentohet ku konsistojnë mospërputhjet e të dhënave. Arsyet e

refuzimit janë të shkurta, të përmbledhura në një fjali dhe të paargumentuara gjerësisht nga ana e bazës ligjore dhe mjedisore si dhe përgjithësisht janë të natyrës së gabimeve të vogla në kundërshtim me Kreun IV pika 5 të VKM nr.419, datë 25.06.2014. Nga formulimi përgjithësues, pa përcaktuar konkretisht mangësitë e aplikimit, DRM Lezhë nuk i ka mundur subjekteve që të njihen me këto mangësi me qëllim që në aplikimin e ri të kenë dijeni se çfarë duhet të saktësojnë dhe korrigjojnë (*Më hollësisht trajtuar më gjerësisht në faqet 58--60 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

16.1. Rekomandim: Agjencia Rajonale Mjedisore Lezhë të marrë masa për të bërë një rivlerësim të dosjeve të refuzuara të lejeve mjedisore C, të cilat transferohen në kategorinë e lejeve B, të cilat të argumentohen ligjërisht për shkaqet e refuzimit, si dhe të informojë subjektet përkatëse mbi mangësitë që duhet të korrigjohen në aplikimin e ri për lejet mjedisore të tipit B.

Brenda muajit Mars 2021

17. Gjetje nga auditimi: Për vitin 2018, DRISHMPUT, Sektori i Mjedisit, ka kryer 201 inspektime dhe ka vendosur në total 9 gjoba, ndërkohë që grupi i auditimit nga inspektimeve e dosjeve, ka konstatuar se nuk janë vendosur gjoba edhe në raste flagrante të shkeljes së ligjit, sikurse janë mungesa e lejes mjedisore apo operimi në kundërshtim me lejen. Për vitin 2019 rezulton se janë realizuar 303 inspektime nga Sektori i Mjedisit dhe janë vendosur vetëm 3 gjoba në vlerën 1,800,000 lekë, të cilat janë rrëzuar nga Komisioni i Ankimit në Inspektoratin Qendror. Nga shqyrtimi i 303 inspektimeve, janë kryer jashtë planit 151 inspektime ose 50% në kundërshtim me Urdhrin e Inspektoratit Qendror nr.13, datë 23.04.2015 "Për miratimin e manualit të përgjithshëm të inspektimit në Republikën e Shqipërisë". Nga 9 gjoba të vendosura nuk është arkëtuar asnjë gjobë në vlerën 3,900,000 lekë (pa kamatë vonesa) të cilat përbëjnë të ardhura të munguara (*Më hollësisht trajtuar në faqet 73-101 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

17.1.Rekomandim: Agjencia Rajonale Mjedisore Lezhë, në kuadër të kompetencave të reja si institucion inspektimi, me shkrirjen e DRISHMPUT-së, të marrë masa për të hartuar një program inspektimi në bazë risku, duke veçuar subjektet që operojnë në zonat e mbrojtura, brenda zonave të banimit si dhe zonave bregdetare në një regjistër të veçantë.

Brenda muajit Mars 2021

18. Gjetje nga auditimi: Për lejet mjedisore të tipit C, në gjithë qarkun e Lezhës janë të regjistruar vetëm 531 subjekte ndërkohë që rezultojnë të paktën 700 subjekte pa leje mjedisore të tipit C, sipas një statistike të Drejtorisë së Tatimeve Lezhë. ISHMPUT Lezhë nuk ka marrë asnjë masë duke rakorduar edhe me institucione të tjera, si Drejtoria Rajonale Tatimore Lezhë, bashkitë Lezhë, Kurbin dhe Mirditë ndonëse ka patur shkresa të dërguar nga DRM Lezhë për këtë problematikë, për identifikimin e subjekteve pa leje dhe kryerjen e inspektimeve përkatës. Të paktën, vetëm nga pagesa e tarifës prej 10,000 lekë konstatohen të ardhura të munguara në vlerën 7,000,mijë lekë dhe për moskryerjen e inspektimeve dhe marrjen e masave me gjobë, në bazë të Ligjit Nr.10448 datë 17.07.2011 "Për lejet e mjedisit", Nenin 29 "Kundërvajtjet" pika a/ii (*Më hollësisht trajtuar në faqet 73-101 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

18.1.Rekomandim: Agjencia Rajonale Mjedisore Lezhë, në bashkëpunim me Drejtorinë e Tatimeve Lezhë, të marrë masa që të kërkojë listën e subjekteve që operojnë në qarkun e Lezhë, për të identifikuar subjektet që nuk janë të pajisur me lejen mjedisore përkatëse, veçanërisht subjektet që me ndryshimet e reja ligjore transferohen në lejen mjedisore të tipit B.

Brenda muajit Mars 2021

19. Gjetje nga auditimi: Nga Inspektorati Shtetëror i Mjedisit, Pyjeve, Ujërave dhe Turizmit Lezhë (DRISHMPUT), janë kryer inspektime në 9 subjekte, në të cilat ndonëse janë konstatuar se ushtrojnë veprimtari pa leje mjedisore të tipit C, nuk është marrë asnjë masë administrative me

gjobë. Për pasojë, konstatohet të ardhura të munguar për buxhetin e shtetit nga mos vendosja e gjobave për 9 subjekte në vlerën 2,700,000 lekë (300,000 gjoba minimale*9 subjekte). Në disa raste, inspektorët e DRIMSHPUT Lezhë kanë vendosur masë “paralajmërim” në kundërshtim me ligjin nr.10433 datë 16.06.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, neni 48/1 e cila përcakton se paralajmërimi vendoset vetëm në rastet *“kur konstatohet shkelje e kërkesave ligjore, që përbën kundërvajtje administrative, por që është e një rëndësie të vogël, apo për të cilën ligji i posaçëm nuk parashikon dënimin përkatës administrativ, subjekti i inspektimit dënohet me ‘paralajmërim’*. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me ligjin Nr.10448, datë 14.7.2011 “Për lejet e mjedisit”, nenin 29 “Kundërvajtjet” pika a/ii (*Më hollësisht trajtuar në faqet 101-117 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

19.1.Rekomandim: Agjencia Rajonale Mjedisore Lezhë të marrë masa për të kryer inspektime në 9 subjektet që nuk janë pajisur me leje mjedisore ,të evidentuara nga auditimi, për të cilat DRISHMPUT-t nuk ka marrë masë administrative me gjobë.

Brenda muajit Mars 2021

20. Gjetje nga auditimi: Në 1 rast, për subjektin me riskun më të lartë “X” sh.p.k. me leje mjedisore të tipit A (një nga dy gjithsej në qarkun e Lezhës me këtë leje) me veprimtarinë “Fabrikë tulle, qeramike” nuk është konstatuar asnjë shkelje por është lënë këshilla që të zbatohet kërkesat ligjore të lejes mjedisore në vijimësi, pa theksuar se cilat kërkesa apo çfarë kushtesh nuk ka plotësuar subjekti, ndërkohë që shkarkimet në ajër i bën përmes një oxhaku të vjetër ku emetohen tymra në kundërshtim me Kushtin 7 të lejes mjedisore për shkarkimet në ajër. Për rrjedhojë, inspektorët nuk kanë marrë asnjë masë administrative me gjobë ndaj subjektit në kundërshtim me nenin 29 “Kundërvajtjet” pika b/i *“Mos përmbushja dhe mosrespektimi i kërkesave, parimeve dhe kushteve të lejes përkatëse të mjedisit të tipit A nga operatori i një instalimi dënohet me gjobë në vlerën nga 1,000,000 deri në 2,000,000 lekë”*. Për rrjedhojë, nga mungesa e vendosjes së gjobës konstatohen të ardhura të munguara në vlerën **1,000,000 lekë** (*Më hollësisht trajtuar në faqen 82 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

20.1.Rekomandim: Agjencia Rajonale Mjedisore Lezhë të marrë masa për të inspektuar çdo 6 muaj, subjektet me risk të lartë për ndotjen e mjedisit, të kategorisë së lejes mjedisore të tipit A(dy gjithsej), duke krijuar një regjistër të veçantë inspektimi për këto subjekte. Në këtë kuadër, DRM Lezhë të marrë masa për rishqyrtimin e inspektimit të kryer në subjektin e trajtuar mësipërm dhe të analizojë vërtetësinë e të dhënave të tij.

Brenda muajit Mars 2021

21. Gjetje nga auditimi: Nga shqyrtimi i dosjes me autorizim nr. 059-1,datë 25.06.2018, është realizuar inspektimi i subjektit “X”, bazuar në një ankesë të një qytetari me nr.467 prot, datë 16.06.2018 i cili ka informuar Inspektoratin e Mjedisit mbi shqetësimin se fabrika e këpucëve i ka tharë pemët dhe e ka bërë pusin të papijshëm. Me shkresën nr. 176 prot, datë 28.06.2018, përgjegjësi i sektorit i kthen përgjigje qytetarit se nga verifikimi ne terren ju vu në dijeni subjektit “X” shqetësimi i banorit dhe iu kërkua që të përmirësojë mënyrën e shkarkimeve në ajër nëpërmjet ventilatorëve, por nga ana e inspektorëve nuk janë marrë as mostra apo kampione të tjera për të verifikuar dëmin mjedisor që i është shkaktuar qytetarit. Ky subjekt është inspektuar edhe me datë 24.05.2018 sipas procesverbalit datë nr.033-1 dhe autorizimit nr. 033-2 nga inspektorët dhe nuk është konstatuar asnjë shkelje dhe vendosur masë administrative dënim me gjobë, ndonëse subjekti ka probleme me zbatimin e kushteve të lejes C. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me ligjin Nr.10448, datë 14.07.2011 “Për lejet e mjedisit”, Neni 29 “Kundërvajtjet” pika b/iii *“Mos përmbushja dhe mosrespektimi i kërkesave, parimeve dhe kushteve të lejes përkatëse të mjedisit të tipit C nga operatori i një instalimi dënohet me gjobë*

në vlerën nga 300 000 deri në 500 000 lekë” (Më hollësisht trajtuar në faqet 45-101 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

21.1.Rekomandim: Agjencia Rajonale Mjedisore Lezhë të marrë masa për të shqyrtuar ankesën e qytetarit me nr, 467 prot, datë 16.06.2018 dhe të kryejë inspektim dhe monitorime të vazhdueshme në subjektin përkatës me qëllim verifikimin e zbatimit të kushteve të lejes mjedisore lidhur me shkarkimet në ajër dhe ujërat nëntokësor si dhe të vlerësojë ndotjen mjedisore që i është shkaktuar qytetarit nga aktiviteti i fabrikës.

Menjëherë

22. Gjetje nga auditimi : DRISHMPUT Lezhë, në 3 raste ka inspektuar të njëjtët subjekte më shumë se 2 herë në mënyrë kronologjike duke mos vendosur gjobë në momentin e parë të konstatimit të shkeljes, konkretisht për shkeljen të mos pajisjes me leje mjedisore:

-Në subjektin “X” janë kryer inspektime në tre raste të ndryshme në datat: 24 Korrik 2018; 3 Gusht 2018 dhe 17 Shtator 2018, datë kjo e inspektimit të fundit kur i është vendosur gjobë në vlerën 300,000 lekë.

-Subjekti “Y” është inspektuar në datën 12/07/2018, dhe ndonëse është konstatuar se ushtron veprimtarinë pa leje mjedisore tipit C, në kundërshtim me kuadrin rregullator i është lënë një afat kohor që të pajiset me leje mjedisore në muajin Gusht 2018. ISHMPUT Lezhë e ka inspektuar përsëri me datë 17.08.2018 dhe serish nuk është marrë masë administrative me gjobë, ndonëse subjekti sipas dokumenteve zyrtare ende nuk ishte pajisur me leje mjedisore. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me ligjin nr.10448, datë 14.7.2011 “Për lejet e mjedisit”, Neni 29 “Kundërvajtjet” pika b/iii “Zhvillimi i veprimtarisë pa lejen mjedisore të tipit C dënohet me gjobë në vlerën nga 300,000 lekë deri në 500,000 lekë”. Për pasojë, nga mos vendosja e gjobës konstatohen të ardhura të munguara në vlerën 300,000 lekë.

C-Në rastin e subjektit “Z” është inspektuar me 24.08.2018, kur subjekti ushtronte veprimtarinë pa lejen e mjedisit tipit B për impiant trajtimi të ujërave të ndotura. Inspektorati ka vërtetuar mungesën e lejes tipit B por nuk ka vendosur gjobën përkatëse në kundërshtim me ligjin nr.10 448, datë 14.07.2011 “ Për lejet e mjedisit”, neni 29 kundërvajtjet pika(ii) përcakton se “Zhvillimi i veprimtarisë pa lejen mjedisore të tipit C dënohet me gjobë në vlerën nga 500,000 deri në 1000,000 lekë (Më hollësisht trajtuar në faqet 45-101 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

22.1.Rekomandim: Agjencia Rajonale Mjedisore Lezhë, në kuadër të kompetencave të reja inspektuese, të marrë masa që të kryejë inspektime me qëllim verifikimin e zbatimit të kushteve të lejes mjedisore, për tre subjektet në rast të transferimit të tyre në kategorinë e lejes mjedisore të tipit B.

Brenda muajit Mars 2021

23. Gjetje nga auditimi: Nga Inspektorati Shtetëror i Mjedisit, Pyjeve, Ujërave dhe Turizmit, Lezhë (DRISHMPUT) janë kryer 42 inspektime në periudhën 2018-2019 në subjekte me leje mjedisore të tipit C, të cilët nuk kanë dorëzuar raportet e vetë monitorimit 28 subjekte çdo 6 muaj apo çdo 1 vit, detyrim ky ligjor sipas kushteve të kontratës së lejes mjedisore. Për rrjedhojë, për 28 subjekte nuk është marrë asnjë masë administrative me gjobë. Po ashtu, DRISHMPUT nuk ka rakorduar me DRM Lezhë për inspektimin e 316 subjekteve që sipas evidencave rezultojnë se nuk kanë zbatuar detyrimin për të dorëzuar raportin e vetë monitorimit mjedisor në DRM Lezhë. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin Nr.10 448, datë 14.07.2011 “ Për lejet e mjedisit” Nenin 29 “Kundërvajtjet” pika b/iii “Mos përmbushja dhe mosrespektimi i kërkesave, parimeve dhe kushteve të lejes përkatëse të mjedisit të tipit C nga operatori i një instalimi dënohet me gjobë në vlerën nga 300, 000 deri në 500, 000 lekë”. Për pasojë, për 28 subjekte e inspektuara rezultojnë të ardhura të munguara nga mos vendosja e

gjobave në vlerën 8,400,000 lekë (Më hollësisht trajtuar në faqet 101-117 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

23.1.Rekomandim: Agjencia Rajonale Mjedisore Lezhë të marrë masa për të krijuar një regjistër të ri nga totali prej 531 subjektsh që operojnë me leje mjedisore të tipit C, për ato subjekte që do të transferohen në kategorinë e lejes mjedisore B, të cilat nuk kanë dorëzuar raportet e vetëmonitorimit.

Brenda muajit Mars 2021

24. Gjetje nga auditimi: Në qarkun e Lezhës janë aktive 14 subjekte që ushtrojnë aktivitetin e “Gurore”. Në periudhën 16 -26 janar 2018, janë ngritur grupe pune me institucione të tjera për verifikimin e veprimtarisë së guroreve,, Agjencia e Zonave të Mbrojtura, Inspektorati Qendror por nga ana e ISHMPUT Lezhë nuk janë kryer inspektime në subjektet që ushtrojnë veprimtarinë e guroreve me qëllim vlerësimin e përputhshmërisë me lejet minerare dhe mjedisore. Nga shqyrtimi i evidencave rezulton se ISHMPUT Lezhë nuk ka bërë inspektime në këto subjekte ndonëse 12 prej tyre nuk ka zbatuar kushtet e kontratës për të rehabilituar zonën me sipërfaqe totale prej 147 ha, si detyrim për dëmtimin mjedisor që kryejnë nga aktiviteti. Për pasojë konstatohen të ardhura të munguara nga mos vendosja e gjobave në vlerën $12 \times 300,000 = 3,600,000$ lekë (Më hollësisht trajtuar në faqet 62-65 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

28.1.Rekomandim: Agjencia Rajonale Mjedisore Lezhë, në kuadër të kompetencave të reja inspektuese, të marrë masa për të parashikuar në programin inspektimeve të vitit 2021 subjektet që operojnë në veprimtaritë e guroreve me qëllim verifikimin e zbatimit të kushteve mjedisore.

Brenda muajit Mars 2021

25. Gjetje nga auditimi: Në 2 raste janë inspektuar 2 subjekte jashtë programit, “X” dhe “Y”, dhe nuk është marrë masë administrative ndaj subjekteve me gjobë ndonëse subjektet kanë operuar në mungesë të lejes mjedisore të tipit B.

A-Sipas të dhënave të nxjerra nga Qendra Kombëtare e Licencimit, akti i miratimit të lejes mjedisore të tipit B për veprimtarinë “Rikuperim mbetjesh jo të rrezikshme” me nr.8023 prot, personi juridik “X” sh.p.k e ka marrë lejen mjedisore në datën 17.09.2019 ndërsa inspektimi është kryer në datën 10.11.2018

B- Subjekti “Y”, me veprimtari fabrikë betoni, inspektuar në datën 07.02.2018 i është lënë detyrë që brenda 8 ditëve të paraqesë dokumentacionin ndonëse është konstatuar se nuk ka leje mjedisore, e cila është miratuar në datën 24.09.2018, sipas aktit me nr.7461 prot., veprime këto në kundërshtim me nenin 29 “Kundërvajtjet” pika a/ii “Zhvillimi i veprimtarisë pa lejen mjedisore të tipit B dënohet me gjobë në vlerën nga 500 000 deri në 1 000 000 lekë”. Për pasojë, nga mosvendosja e gjobës konsiderohen të ardhura të munguara në vlerën 1000,000 lekë [$2 \times 500,000$ gjobë minimale](Më hollësisht trajtuar në faqet 77-101 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

29.1.Rekomandim: Agjencia Rajonale Mjedisore Lezhë, në kuadër të kompetencave të reja inspektuese, të marrë masa për të inspektuar subjektet e mësipërme, me qëllim verifikimin e zbatimit të kushteve të lejes mjedisore.

Brenda muajit Mars 2021

26. Gjetje nga auditimi: Gjatë vitit 2018 nga ana e ISHMPUT Lezhë, sektori i Pyjeve janë konstatuar 20 raste të sekuestrimit të materialit drusor nga këto 12 raste dru zjarri dhe 8 raste lëndë punimi. Sasia totale e materialit drusor të sekuestruar është 204.4 m^3 , nga të cilat 32.1 janë konstatuar në Bashkinë Lezhë; 147.6 m^3 në Bashkinë Mirditë dhe 4 m^3 në Bashkinë Kurbin. Për vitin 2019, janë sekuestruar rreth 468 m^3 për 9 raste vetëm në Bashkinë Mirditë. Për sasinë totale prej 672 m^3 lëndë drusore të sekuestruar, me vlerë shitjeje ankandi të paktën 4,325,740 lekë,

ISHMPUT Lezhë dhe sektori i pyjeve, nuk ka marrë masa për të bërë hyrje të lëndës drusore në magazinë dhe më pas transferimin e tij tek bashkia përkatëse në kundërshtim me ligjin Nr.9385, datë 04.05.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor” neni 39 dhe UMF nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, kreu III “Dokumentimi i lëvizjes së aktiveve”. Për rrjedhojë, mungon dokumentacioni që vërteton hyrjen e këtij materiali drusore në ISHMPUT Lezhë dhe fletë-hyrja që materiali i është dorëzuar bashkive përkatëse.

-Gjithsej janë marrë 24 masa administrative me gjobë në vlerën 11,448,000 lekë për dy vite. Nga ana e Inspektoratit të Mjedisit, Pyjeve, Ujërave dhe Turizmit Lezhë nuk është marrë asnjë masë për arkëtimin e gjobave të vendosura, duke sjellë të ardhura të munguara në vlerën 11,448,000 lekë. *(Më hollësisht trajtuar në faqet 101-117 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

30.1.Rekomandim: Agjencia Rajonale Mjedisore Lezhë të kërkojë nga bashkitë përkatëse, konkretisht Bashkia Lezhë, Bashkia Kurbini dhe Bashkia Mirditë, një informacion nëse lëndët drusore të sekuestruara prej 672 m³ janë bërë hyrje në bashki, si dhe të njoftojë Inspektoratin Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit për rastet e konstatuara, si strukturën përgjegjëse për pyjet me ndryshimet e reja ligjore.

Menjëherë

C. MASA PËR ARKËTIMIN E TË ARDHURAVE TË MUNGUARA

1. Për Drejtorinë Rajonale të Mjedisit Lezhë, në fund të vitit 2018, rezultojnë të pajisur 404 subjekte me leje mjedisore të tipit C ndërsa në vitin 2019 rezultojnë 531 subjekte me leje mjedisore të tipit C. Për vitin 2018 rezulton se nuk kanë likuiduar tarifën 159 subjekte në shumën 318,000 lekë ndërsa në vitin 2019 nuk kanë likuiduar tarifën 382 subjekte në shumën 764,000 lekë, duke sjellë të ardhura të munguara për 2018-2019 në vlerën 1,082, mijë lekë.

2. Për Inspektoratin Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve, Ujërave dhe Turizmit, Sektori i Mjedisit dhe Pyjeve rezultojnë të ardhura të munguara në vlerën 39,048 mijë lekë, si vijon:

-Të ardhura të munguara për mos marrjen e masave për arkëtimin e 9 gjobave për vitin 2018, në vlerën 3,900 mijë lekë;

-Të ardhura të munguar për buxhetin e shtetit nga mosvendosja e gjobave për 9 subjekte, të inspektuar dhe të pa pajisur me leje mjedisore C në vlerën 2,700, mijë lekë;

-Të ardhura të munguara, në 3 raste për inspektime të kryera në subjekte pa leje mjedisore/shkelje të lejes mjedisore B dhe A, për mos vendosje gjobe në vlerën 2,000 mijë lekë;

-Të ardhura të munguara nga mos vendosja e gjobave për 12 subjekte me veprimtari gurore të cilat nuk ka zbatuar kushtet e kontratës për të rehabilituar zonën me sipërfaqje totale prej 147 ha në vlerën 3,600, mijë lekë.

-Të ardhura të munguara nga mosvendosja e gjobave për 28 subjekte të inspektuara, që nuk kanë dorëzuar raportet e vetëmonitorimit në vlerën 8,400 mijë lekë.

-Nga mos pagesa e tarifës mjedisore për të paktën 700 subjekte në qarkun e Lezhës që nuk janë të pajisur me leje përkatëse të tipit C, regjistruhen të ardhura të munguara në vlerën 7,000, mijë lekë;

-Nga mos arkëtimi i gjobave të vendosura për Sektorin e Pyjeve, duke sjellë të ardhura të munguara në vlerën 11,448,000 lekë.

1.1.Rekomandim: Agjencia Rajonale Mjedisore Lezhë të marrë masa për arkëtimin e të ardhurave që u përkasin debitorëve të lejes mjedisore C në vlerën 1,082, mijë lekë si dhe në kuadër të kompetencave të reja të inspektimit mjedisor, të vlerës së 9 gjobave të paarkëtuara nga Inspektorati Mjedisit për vitin 2018, në vlerën 3,900 mijë lekë.

Menjëherë

C. MASA DISIPLINORE

C.1. PËR PUNONJËSIT NË MARRËDHENIE PUNE

C.1.1. Për punonjësit të cilët janë pjesë e Shërbimit Civil

Mbështetur në nenin 58 “Llojet e masave disiplinore”, nenin 59 “Kompetencat dhe procedurat për masat disiplinore” të ligjit nr. 152/2013, datë 30.05.2013 “Për nëpunësin civil” dhe VKM nr.171, datë 26.03.2014 “Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirimimin nga shërbimi civil” i ndryshuar, në kushtet kur Drejtoria Rajonale e Mjedisit dhe Inspektorati Shtetëror i Mjedisit, Pyjeve dhe Ujërave janë përfshirë në procese të ristrukturimit, kërkojmë nga titullari i Agjencisë Kombëtare të Mjedisit të vlerësojë marrjen e masave disiplinore për punonjësit si mëposhtë, në varësi të shkallës së përgjegjësisë individuale:

1. Për z. B.F., me detyrë Drejtor i Drejtorisë Rajonale Mjedisore Lezhë

-Për mos marrjen e masave për revokimin e lejes mjedisore për subjektet me leje mjedisore të tipit C që nuk kanë likuiduar tarifën vjetore, veprime në kundërshtim me pikën 6 të nenit 25 të Ligjit Nr.10448 datë 17.07.2011 “Për lejet e mjedisit” ku përcaktohet se “Agjencia përkatëse Rajonale e Mjedisit i kërkon QKL-së revokimin e lejes së mjedisit të tipit C, në rast se operatori i këtij instalimi nuk ka kryer pagimin e tarifës përkatëse në zbatim të këtij ligji”. (Më hollësisht trajtuar më gjerësisht në faqet 9-10 të projekt-raportit).

-Në 1 rast, për miratimin e lejes mjedisore të tipit C të personit juridik “X” në kundërshtim me Ligjin Nr.10448 datë 17.07.2011 “Për lejet e mjedisit”, Shtojca 1 “Lejet e mjedisit të tipave A, B dhe C në varësi të kapacitetit prodhues kufi”. Sipas kapacitetit, subjekti i përket kategorisë së lejeve mjedisore të tipit B.

2. Për znj. J.Sh., me detyrë specialiste, në cilësinë e anëtarit të komisionit të vlerësimit të dosjeve të lejeve mjedisore të tipit C

-Në 2 raste nuk ka administruar kontratën e shërbimit të subjektit me operatorë të licencuar në fushën e “landfillit” dhe transferimin e mbetjeve, në kundërshtim me VKM nr.419, datë 25.06.2014 “Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi të tipave A, B dhe C, për transferimin e lejeve nga një subjekt te tjetri, të kushteve për lejet respektive të mjedisit, si dhe rregullave të hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKL-ja”, kushti 6 i kontratës tip “Menaxhimi i Mbetjeve” dhe VKM nr.229, datë 23.04.2014 “Për Miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe të dokumentit të transferimit të mbetjeve jo të rrezikshme.

-Në 7 raste, nuk ka administruar certifikatën e pronësisë mbi objektin ku zhvillohet veprimtaria e përcaktuar për lejet mjedisore, në kundërshtim me VKM nr. 419, datë 25.6.2014 “Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi të tipave A, B dhe C, për transferimin e lejeve nga një subjekt te tjetri, të kushteve për lejet respektive të mjedisit, si dhe rregullave të hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKL-ja”, Shtojca 3.

- Në 5 raste, ka dhënë pëlqimin për miratimin e lejes mjedisore të tipit C për aktivitete që subjektet nuk i kanë patur pjesë të veprimtarisë sipas ekstraktit të QKB, në kundërshtim me VKM nr.419, datë 25.06.2014 “Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi të tipave A, B dhe C, për transferimin e lejeve nga një subjekt te tjetri, të kushteve për lejet respektive të mjedisit, si dhe rregullave të hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKL-ja”, Shtojca 3.

-Në 1 rast ka dhënë pëlqimin për miratimin e lejes mjedisore të tipit C të personit juridik “X” në kundërshtim me Ligjin Nr.10448 datë 17.07.2011 “Për lejet e mjedisit”, Shtojca 1 “Lejet e

mjedisit të tipave A, B dhe C në varësi të kapacitetit prodhues kufi”. Sipas kapacitetit, subjekti i përket kategorisë së lejeve mjedisore të tipit B.

-Në 7 raste, ka dhënë pëlqimin për miratimin e lejes mjedisore të tipit C për veprimtari “magazinin i hekurishteve/skrapeve të metalit që nuk përmbajnë materiale të rrezikshme” si dhe për aktivitete “riparim pajisjesh motorike” në kundërshtim me kushtet e lejes C, konkretisht në mungesë të kontratës së shërbimit me operatorë të licencuar për largimin dhe asgjësimin e mbetjeve metalike dhe të ngurta.

3.Për z.E,Gj. me detyrë specialist, në cilësinë e anëtarit të komisionit të vlerësimit të dosjeve të lejeve mjedisore të tipit C

- Në 1 rast ka dhënë pëlqimin për miratimin e lejes mjedisore të tipit C të personit juridik “X” në kundërshtim me Ligjin Nr.10448 datë 17.07.2011 “Për lejet e mjedisit”, Shtojca 1 “Lejet e mjedisit të tipave A, B dhe C në varësi të kapacitetit prodhues kufi”. Sipas kapacitetit, subjekti i përket kategorisë së lejeve mjedisore të tipit B.

- Në 3 raste nuk ka administruar kontratën e shërbimit të subjektit me operatorë të licencuar në fushën e “lendfillit” dhe transferimin e mbetjeve në kundërshtim me VKM nr.419, datë 25.06.2014 “Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi të tipave A, b dhe c, për transferimin e lejeve nga një subjekt te tjetri, të kushteve për lejet respektive të mjedisit, si dhe rregullave të hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKL-ja”, kushti 6 i kontratës tip “Menaxhimi i Mbetjeve” dhe VKM nr.229, datë 23.04.2014 “Për Miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe të dokumentit të transferimit të mbetjeve jo të rrezikshme.

-Në 6 raste, nuk ka administruar certifikatën e pronësisë mbi objektin ku zhvillohet veprimtaria e përcaktuar për lejet mjedisore, në kundërshtim me VKM nr 419, datë 25.6.2014 “Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi të tipave A, B dhe C, për transferimin e lejeve nga një subjekt te tjetri, të kushteve për lejet respektive të mjedisit, si dhe rregullave të hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKL-ja”, Shtojca 3.

-Në 5 raste, ka dhënë pëlqimin për miratimin e lejes mjedisore të tipit C për aktivitete që subjektet nuk i kanë patur pjesë të veprimtarisë sipas ekstraktit të QKB, në kundërshtim me VKM nr 419, datë 25.06.2014 “Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi të tipave A, B dhe C, për transferimin e lejeve nga një subjekt te tjetri, të kushteve për lejet respektive të mjedisit, si dhe rregullave të hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKL-ja”, Shtojca 3.

-Në 7 raste, ka dhënë pëlqimin për miratimin e lejes mjedisore të tipit C për veprimtari “magazinin i hekurishteve/skrapeve të metalit që nuk përmbajnë materiale të rrezikshme” si dhe për aktivitete “riparim pajisjesh motorike” në kundërshtim me kushtet e lejes C, konkretisht në mungesë të kontratës së shërbimit me operatorë të licencuar për largimin dhe asgjësimin e mbetjeve metalike dhe të ngurta.

4. Për z.Sh.F. me detyrë specialist, në cilësinë e anëtarit të komisionit të vlerësimit të dosjeve të lejeve mjedisore të tipit C

- Në 1 rast ka dhënë pëlqimin për miratimin e lejes mjedisore të tipit C të personit juridik “X” në kundërshtim me Ligjin Nr.10448 datë 17.07.2011 “Për lejet e mjedisit”, Shtojca 1 “Lejet e mjedisit të tipave A, B dhe C në varësi të kapacitetit prodhues kufi”. Sipas kapacitetit, subjekti i përket kategorisë së lejeve mjedisore të tipit B.

-Në 3 raste nuk ka administruar kontratën e shërbimit të subjektit me operatorë të licencuar në fushën e “lendfillit” dhe transferimin e mbetjeve në kundërshtim me VKM nr.419, datë 25.06.2014 “Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi të tipave A, b dhe c, për transferimin e lejeve nga një subjekt te tjetri, të kushteve për lejet respektive të mjedisit, si dhe rregullave të hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet

kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKL-ja”, kushti 6 i kontratës tip “Menaxhimi i Mbetjeve” dhe VKM nr.229, datë 23.04.2014 “Për Miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe të dokumentit të transferimit të mbetjeve jo të rrezikshme.

- Në 8 raste, nuk ka administruar certifikatën e pronësisë mbi objektin ku zhvillohet veprimtaria e përcaktuar për lejet mjedisore, në kundërshtim me VKM nr 419, datë 25.6.2014 “Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi të tipave A, B dhe C, për transferimin e lejeve nga një subjekt te tjetri, të kushteve për lejet respektive të mjedisit, si dhe rregullave të hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKL-ja”, Shtojca 3.

-Në 5 raste, ka dhënë pëlqimin për miratimin e lejes mjedisore të tipit C për aktivitete që subjektet nuk i kanë patur pjesë të veprimtarisë sipas ekstraktit të QKB, në kundërshtim me VKM nr 419, datë 25.06.2014 “Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi të tipave A, B dhe C, për transferimin e lejeve nga një subjekt te tjetri, të kushteve për lejet respektive të mjedisit, si dhe rregullave të hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKL-ja”, Shtojca 3.

-Në 7 raste, ka dhënë pëlqimin për miratimin e lejes mjedisore të tipit C për veprimtari “magazinin i hekurishteve/skrapeve të metalit që nuk përmbajnë materiale të rrezikshme” si dhe për aktivitete “riparim pajisjesh motorike” në kundërshtim me kushtet e lejes C, konkretisht në mungesë të kontratës së shërbimit me operatorë të licencuar për largimin dhe asgjësimin e mbetjeve metalike dhe të ngurta.

5.Për znj.V.Gj., me detyrë specialiste, në cilësinë e anëtarit të komisionit të vlerësimit të dosjeve të lejeve mjedisore të tipit C

-Në 1 rast ka dhënë pëlqimin për miratimin e lejes mjedisore të tipit C të personit juridik “X” në kundërshtim me Ligjin Nr.10448 datë 17.07.2011 “Për lejet e mjedisit”, Shtojca 1 “Lejet e mjedisit të tipave A, B dhe C në varësi të kapacitetit prodhues kufi”. Sipas kapacitetit, subjekti i përket kategorisë së lejeve mjedisore të tipit B.

-Në 3 raste nuk ka administruar kontratën e shërbimit të subjektit me operatorë të licencuar në fushën e “lëndfillit” dhe transferimin e mbetjeve në kundërshtim me VKM nr.419, datë 25.06.2014 “Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi të tipave A, b dhe c, për transferimin e lejeve nga një subjekt te tjetri, të kushteve për lejet respektive të mjedisit, si dhe rregullave të hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKL-ja”, kushti 6 i kontratës tip “Menaxhimi i Mbetjeve” dhe VKM nr.229, datë 23.04.2014 “Për Miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe të dokumentit të transferimit të mbetjeve jo të rrezikshme”.

- Në 7 raste, nuk ka administruar certifikatën e pronësisë mbi objektin ku zhvillohet veprimtaria e përcaktuar për lejet mjedisore, në kundërshtim me VKM nr.419, datë 25.6.2014 “Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi të tipave A, B dhe C, për transferimin e lejeve nga një subjekt te tjetri, të kushteve për lejet respektive të mjedisit, si dhe rregullave të hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKL-ja”, Shtojca 3.

-Në 5 raste, ka dhënë pëlqimin për miratimin e lejes mjedisore të tipit C për aktivitete që subjektet nuk i kanë patur pjesë të veprimtarisë sipas ekstraktit të QKB, në kundërshtim me VKM nr 419, datë 25.06.2014 “Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi të tipave A, B dhe C, për transferimin e lejeve nga një subjekt te tjetri, të kushteve për lejet respektive të mjedisit, si dhe rregullave të hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKL-ja”, Shtojca 3.

-Në 7 raste, ka dhënë pëlqimin për miratimin e lejes mjedisore të tipit C për veprimtari “magazinin i hekurishteve/skrapeve të metalit që nuk përmbajnë materiale të rrezikshme” si dhe për aktivitete “riparim pajisjesh motorike” në kundërshtim me kushtet e lejes C, konkretisht në

mungesë të kontratës së shërbimit me operatorë të licencuar për largimin dhe asgjësimin e mbetjeve metalike dhe të ngurta.

6. Për znj.A.N., me detyrë specialiste, në cilësinë e anëtarit të komisionit të vlerësimit të dosjeve të lejeve mjedisore të tipit C

- Në 1 rast nuk ka administruar kontratën e shërbimit të subjektit me operatorë të licencuar në fushën e “lendfillit” dhe transferimin e mbetjeve në kundërshtim me VKM nr.419, datë 25.06.2014 “Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi të tipave A, b dhe c, për transferimin e lejeve nga një subjekt te tjetri, të kushteve për lejet respektive të mjedisit, si dhe rregullave të hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKL-ja”, kushti 6 i kontratës tip “Menaxhimi i Mbetjeve” dhe VKM nr.229, datë 23.04.2014 “Për Miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe të dokumentit të transferimit të mbetjeve jo të rrezikshme”.

-Në 1 rast, nuk ka administruar certifikatën e pronësisë mbi objektin ku zhvillohet veprimtaria e përcaktuar për lejet mjedisore, në kundërshtim me VKM nr.419, datë 25.6.2014 “Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi të tipave A, B dhe C, për transferimin e lejeve nga një subjekt te tjetri, të kushteve për lejet respektive të mjedisit, si dhe rregullave të hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKL-ja”, Shtojca 3.

7. z.A.M., me detyrë inspektor

-Në 8 raste, ka inspektuar subjekte të cilat ndonëse nuk kanë dorëzuar raportet e vetë monitorimit sipas kushteve të lejes mjedisore të tipit c, nuk është konstatuar asnjë shkelje. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin Nr.10448 datë 17.07.2011 “Për lejet e mjedisit”, neni 29 “Kundërvajtjet” pika b/iii “Mospërmbushja dhe mosrespektimi i kërkesave, parimeve dhe kushteve të lejes përkatëse të mjedisit të tipit C nga operatori i një instalimi dënohet me gjobë në vlerën nga 300 000 deri në 500 000 lekë”.

9. z.E.P., me detyrë inspektor

-Në 4 raste, ka inspektuar subjekte të cilat ndonëse nuk kanë dorëzuar raportet e vetë monitorimit sipas kushteve të lejes mjedisore të tipit c, nuk është konstatuar asnjë shkelje. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin Nr.10448 datë 17.07.2011 “Për lejet e mjedisit”, neni 29 “Kundërvajtjet” pika b/iii “Mos përmbushja dhe mosrespektimi i kërkesave, parimeve dhe kushteve të lejes përkatëse të mjedisit të tipit C nga operatori i një instalimi dënohet me gjobë në vlerën nga 300 000 deri në 500 000 lekë.

10.Për z.I.D., në cilësinë e përgjegjësit të sektorit të mjedisit dhe inspektorit, aktualisht përgjegjës i sektorit të të dhënave në DRM Lezhë

-Në 3 raste, në cilësinë e inspektorit, ndonëse është konstatuar se subjekti nuk disponon lejen mjedisore, nuk është vendosur gjobë por është lënë këshilla që të pajiset me leje deri në datë 27.08.2018, në kundërshtim me Ligjin Nr.10448 datë 17.07.2011 “Për lejet e mjedisit”, neni 29, “Kundërvajtje” pika iii ku përcaktohet “se pa lejen përkatëse të mjedisit të tipit C, dënohet me gjobë në vlerën nga 300,000 deri në 500, 000 lekë”

-Në 1 rast, në inspektimin e subjektit “X”, ndonëse për subjektin kishte ankesë për shkelje të kushteve të lejes mjedisore, konkretisht ndotje pusi të një qytetari, nuk është marrë administrative me gjobë, në kundërshtim me Ligjin Nr.10448 datë 17.07.2011 “Për lejet e mjedisit”, neni 29, “Kundërvajtje”.

-Në 1 rast, në inspektimin e subjektit me leje mjedisore të tipit A me veprimtari fabrikë tulle, nuk është marrë asnjë masa administrative me gjobë ndonëse ndaj subjektit ka patur ankesa dhe emeton tymra nga një oxhak i vjetër, në shkelje të kushteve të lejes mjedisore.

C.2. PËR PUNONJËSIT E LARGUAR.

Për ish punonjësit e mëposhtëm nuk rekomandojmë masa disiplinore edhe sepse shkeljet e natyrës administrative të konstatuara, pavarësisht se ekzistojnë nuk mund të ezaurohen si të tilla, pasi personat e sipërpërmendur nuk janë në marrëdhënie pune me këtë institucion dhe nuk ka adresim institucional për dhënien e zbatimit të tyre. Drejtoria Rajonale e Mjedisit, (DRM) Qarku Lezhë i është nënshtruar ristrukturimit ndërsa Drejtoria Rajonale e Inspektorati Shtetëror Mjedisit, Pyjeve, Ujërave dhe Turizmit Lezhë (ish DR ISHMPUT Lezhë) është shkëputur, në kuadrin e reformimit në shkallë vendi të këtij institucioni. Nga ana jonë në bazë të shkeljeve të konstatuara, masa disiplinore do të ishte:

I. “Largim nga shërbimi civil”

1. Për znj. A.F., *me detyrë kryeinspektor i komanduar dhe inspektor*
2. Për z.A.D., *detyrë kryeinspektor i komanduar dhe përgjegjës i sektorit të pyjeve*
3. Për z.K.F., *me detyrë përgjegjës i sektorit të Pyjeve Lezhë për Mirditën për vitin 2018*
4. Për z.A.N., *përgjegjës i sektorit të Pyjeve Lezhë për Mirditën për vitin 2019*
5. Për z.K.L., *me detyrë inspektor*
6. Për z.H.N., *me detyrë inspektor*

II. “Vërejtje” deri “Largim nga shërbimi civil”.

1. Për z.E.K., *me detyrë inspektor*
2. Për z.G.Gj., *me detyrë inspektor*
3. Për z.M.D., *me detyrë inspektor*
5. Për z.M.K., *me detyrë inspektor*
5. Për z.A.V., *me detyrë inspektor*
6. Për z.G.B., *me detyrë inspektor*
7. Për z.Q.S., *me detyrë inspektor*
8. Për z. M.D. , *me detyrë inspektor*
9. Për znj.B.T., *arkiviste/magaziniere*
10. Për znj.K.Gj, *arkiviste/magaziniere*

III. “Vërejtje”

1. Për z.T.P *me detyrë inspektor*
2. Për z.B.S, *me detyrë inspektor*
3. Për z.A.N, *me detyrë inspektor*

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Aseteve dhe Mjedisit.

KRYETAR

Arben SHEHU